



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	49/25
Nr. i fq. / Br. st	- 7 -
Data: / Datum	17.03.2025
VUSHTRRI - VUÇITRN	



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 shkurt 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Agron Perçuku, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi, kryetar i komunës, drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se përmes postës elektronike na ka ardhë një pikë shtesë për ta shtuar në rend të ditës:

- Propozim - vendim për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit” (postmortum) për Latif Berishën.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – dua ta sqaroj se titulli “Nderi i Qytetit” u jepet banorëve të qytetit të Vushtrrisë, kurse titulli “Qytetar Nderi” u jepet personave që nuk janë banorë të qytetit tonë. Prandaj, unë mendoj që ky propozim duhet të modifikohet dhe të bëhet “Qytetar Nderi”, sepse i ndjeri Latif Berisha ka qenë banorë i komunës së Mitrovicës.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi që të shtohet në rend të ditës pika shtesë.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 20.01.2025
2. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024
3. Propozim – vendim për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Vushtrrisë
4. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja për vitin 2022,2023 dhe 2024 e lokaleve, pronë komunale në sheshin “Adem Jashari”
5. Raport për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2024
6. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, në muajt korrik dhe gusht 2024
7. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë

8. Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2024
9. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024
10. Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025
11. Kërkesë për përkrahje financiare
12. Propozim - vendim për dhënien e titullit "Nderi i Qytetit".
13. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.12.2024.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 20.01.2025.

2. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Propozim – vendim për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Vushtrrisë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – ajo tha se ka shumë rrugë që janë shpronësuar, ku janë ndërtuar banesat. Aty nuk ka mbetur më rrugë as rrugicë, kurse tabela me emër ka mbetur. Kishte me qenë mirë të bëhet një komision për këtë çështje dhe të bëhet në bazë të planit urbanistik, kurse emrat e rrugëve që nuk ekzistojnë të hiqen dhe të vendosen diku tjetër.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – deklaroi se me disa emra të rrugëve nuk pajtohet. Psh. Te draft – lista rezervë, nr. 49 "Gazivoda", mendoj që është ofendim ta kalojmë në kuvend, sepse ai e ka emrin shqip "Ujmani", nëse po mendohet për liqenin. Pastaj, e pashë diku "Republika 2008", më mirë është të jetë "Pavarësia 2008".

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – propozoi që kësaj liste t'i shtohet emri "Ahmet Zariqi" për emërtimin e ndonjë rruge apo sheshi, i cili ka kontribuar në zhvillimin e qytetit të Vushtrrisë. Po ashtu, edhe familja e tij është duke kontribuar në zhvillimin e qytetit, ku është hapur një fond në emër të të ndjerit për ndihmë të familjeve që kanë nevojë.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – edhe unë pajtohem që ka pasur emra të rrugëve që tani më nuk ekzistojnë dhe se dikush nga familjarët mund të lëndohet. Unë mendoj që kjo listë duhet të kthehet dhe ta rishikojmë.

Fakete Dushi, anëtare e KPF-së – tha se ka disa propozime për t'u futur në listë. Në fshatin Novolan, në rrugën kryesore "Artakolli" është një lagje që nuk ka emërtim të rrugës fare. Ata janë ardhur me një propozim që ajo rrugë ta ketë emrin "Haxhi Beshiri". Po ashtu, është një lagje që është e emërtuar me emrin "Guria", por banorët nuk po pajtohen me atë emërtim, të cilin e cilësojnë si të papërshtatshëm. Ata po kërkojnë që këtë rrugë ta emërtojnë me emrin "Ukë Kutillovci".

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – prej draft-listës rezervë prej 280 emrave, vetëm një emër është i gjinisë femërore. Prandaj, po kërkoj që të ketë më shumë përfaqësim gjinor edhe te emrat e rrugëve. Edhe unë pajtohem që të kthehet kjo dhe të bëhen përmirësime.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – është një problem në fshatin Nedakoc, që është marrë një vendim nga ish-drejtori i Urbanizmit me një komision për emërtimin e rrugës, pa ardhur fare në kuvend. Kurse, ato dy familje kanë probleme, qç sa jam në dijeni lënda është edhe në gjykatë. Është mirë Drejtoria për Urbanizëm të merret me këtë çështje dhe të na vjen për të vendosur në kuvend. Bëhet fjalë për rrugën “Zeqir Gubetini”, e cila në kuvend nuk ka kaluar që të emërtohet, por drejtori me komision e kanë bërë emërtimin dhe e kanë ndryshuar emrin e rrugës.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se kjo temë është e ndjeshme dhe nganjëherë krijon mospajtime në mes lagjeve. Por, e rëndësishme është që komisioni me prioritet t’i shikojë emrat dhe personalitetet nga komuna jonë që kanë dhënë kontribut në fushën e arsimit, kulturës, shëndetësisë, administratës etj.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – edhe unë pajtohem që duhet t’i respektojmë figurat që kanë dhënë kontribut për komunën tonë. Kur jemi te emrat e rrugëve, duhet të jemi shumë objektiv edhe t’ua japim hakun. Prandaj, do ta kthejmë këtë propozim dhe do ta themelojë një komision, në mënyrë që ta analizojmë në detaje.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – lidhur me rrugën në Nedakoc, ajo gjendet në gjeoportal, kurse lidhur me procedurën se si ka ardhur, nuk e di.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – tha se qëllimi im është që të gjendet një zgjidhje në mes atyre dy familjeve.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës, të mos procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, por të themelohet një komision, i cili do t’i analizojë në mënyrë të hollësishme propozimet për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Vushtrrisë.

4. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja për vitin 2022,2023 dhe 2024 e lokaleve, pronë komunale në sheshin “Adem Jashari”.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Raport për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Raport i vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, në muajt korrik dhe gusht 2024.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – pyeti se pse kaq vonë është sjellë ky raport për fatkeqësitë natyrore, kur bëhet fjalë për muajt korrik dhe gusht 2024? Po kam frikë që po

krijojmë shpresë tek ata që u janë shkaktuar dëmet, sepse institucionet tjera ka mundësi që e hudhin poshtë për shkak të vonësës.

Maliq Ferizi, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim – tha se sipas anëtarëve të komisionit, ky raport është proceduar në sekretarinë e kuvendit në muajin nëntor dhe nuk e di pse nuk është përcjell në kuvend.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – nuk besoj që ka ardhur në sekretari, të paktën nuk kam informacione që ka ardhur.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2024 në Komunën e Vushtrrisë.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – thëksoi se drejtori nuk është i pranishëm as në këtë mbledhje e as nuk ka qenë në mbledhjet e kaluara të KPF-së e as kuvendit. E kuptojmë që ka qenë keq me shëndet, por sado pak e ka marrë veten dhe ka pasur mundësi të jetë në mbledhje.

Ai tha se në urgjencën e Vushtrrisë kemi mungesë të mjekëve dhe infermierëve, duke llogaritur ata që dalin në terren. Kërkojmë që të rritet numri i mjekëve dhe infermierëve në urgjencë. Stafit i urgjencës është duke bërë një punë të shkëlqyeshme, duke kryer mbi 100 pacientë brenda ndërrimit. Po ashtu, ai kërkoi që të bëhet ndarja fizike në mes urgjencës dhe QMF-së, për shkak se po përzihen pacientët dhe ka raste që nuk u jepen shërbime për shkak të kësaj përzierjeje.

Mentor Hasani, anëtar i KPF-së – tha se para 2-3 viteve është rritur numri i stafit në urgjencë. Aktualisht kemi dy mjekë dhe katër infermierë që kujdestarojnë 24 orë në urgjencë. Mundësia që të rritet numri i stafit aktualisht nuk ekziston edhe pse sipas mendimit tim nuk është nevoja. Kur mjeku është në terren, është mirë që të jetë një mjek në urgjencë. Bashkëpunimi në mes urgjencës dhe emergjencës është duke funksionuar shumë mirë. Sa jam në dijeni, nuk ka asnjë ankesë lidhur me mos ofrimin e shërbimeve në urgjencë apo QMF që gjenden në objektin e njëjtë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – njëri nga sektorët që kryetarit nuk i ka shkuar puna mirë gjatë gjithë mandatit është shëndetësia. Në dy vitet e para ia kam numëruar problemet, pastaj dikur u bë mjaft. Drejtori i shëndetësisë nuk vjen kurrë në kuvend e as KPF. E di që ka pasur probleme shëndetësore, e mirëkuptojmë në atë pjesë në kuptimin human dhe solidar. Në anën tjetër, po e shohim aktiv në disa pjesë tjera. Përtej kësaj, gjendja në sistemin parësor shëndetësor nuk është në gjendjen e duhur. Për këtë, përgjegjësia bie mbi ata që menaxhojnë. Aty është një staf shumë i mirë dhe njerëz që kanë vullnet të mirë me shërbyer për shëndetin e qytetarëve. Mendoj që ka mundur të bëhet shumë më shumë për shëndetësinë në Vushtri e nuk është bërë. Duhet më shumë promovim dhe më shumë angazhim për të krijuar më shumë kapacitete humane tek pjesa e mjekëve dhe infermierëve, jo tek administrata. Kjo është qasje e gabuar, sepse më shumë po punësohen në administratë të QKMF-së, sesa profesionistë shëndetësor. Ju kisha lutur që të punësoni mjekë nga Vushtria. Për asgjë tjetër mos qofsha krenar, sa kam qenë drejtor i shëndetësisë, asnjë mjek të Vushtrrisë nuk e kam lënë pa punë dhe as nuk ua kam shikuar përkatësinë partiake e as lokalitetin. Mjeku për qytetin është aset që sot ta lyp Evropa dhe jo vetëm

Kosova. Është mëkat me ta marrë mjekun komunat tjera. Arsimin dhe shëndetësinë nuk duhet ta shikojmë me sy politik.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2024.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – e lexova informatën, por ajo që neve na intereson është se ku janë dhënë lejet ndërtimore. Ku janë refuzuar? Pse janë refuzuar? A ka ndërtime pa leje? Çfarë po ndodhë me ndërtimet pa leje? Këto informacione nuk gjenden në informatë. Ajo pyeti se objekti të taksistët, përballë banesave të kuqe, a posedon leje ndërtimore?

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – ai pyeti se kur do të vijnë në kuvend Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Harta Zonale? Cilat janë arsyet e zvarritjes së këtyre dy dokumenteve?

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – deklaroi se vitin e kaluar në këtë kohë kemi diskutuar për PZHK dhe Harta Zonale dhe na është thënë që në maj të vitit 2024 do të vijnë në kuvend PZHK-ja. Tanimë jemi në shkurt të vitit 2025 dhe ende nuk kemi asgjë. Ndërtimet e kanë shndërruar qytetin e Vushtrrisë në një katrahurë urbane, të pamëshirshme dhe në disa vende edhe të pa jetueshme. Nëse komuna nuk ka kapacitete, gjejini një kompani profesionale dhe të bëhet një plan profesional. Nëse nuk bëhet, kujt po i shërbehet? Interesave të grupeve të oligarkëve, të cilat janë të lidhura me ndërtimin dhe nuk ka shpjegim tjetër.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – nuk them se është gjithçka perfekte, por nuk është edhe gjithçka zi. Në mandatin tim, ato rrugë që po bëhen, ato ndërtesa që po ndërtohen, po bëhen me projekte të detajuara dhe po mbikëqyren nga kompanitë e specializuara. Sa i përket PZHK-së dhe Hartës Zonale, është e vërtetë që jemi vonuar. Ne e kemi gjetur një draft të Hartës Zonale, por në ndërkohë i ka skaduar afati PZHK-së dhe kjo ka ndodhur se nuk kemi mundur ta miratojmë hartën zonale pa e bërë PZHK-në. Ai tha se në trend është edhe energjia solare, energjia me erë dhe duhet që të parashihen në PZHK. Kompania është duke punuar dhe besoj që shumë shpejt do të vij në kuvend. Kurse, pas tij do të vjen edhe Harta Zonale.

Drilon Jusufi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – lidhur me pyetjen e parashtruar se a posedon leje objekti të taksistët, ai tha se ky objekt posedon leje ndërtimore, që i ishte lëshuar vitin e kaluar. Kanë bërë kërkesë për renovim, por nuk e kemi shqyrtuar ende.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – lidhur me këtë objekt, aty gjenden dy parcela, ku gjendet objekti i vjetër dhe nuk është ndërtuar asgjë. Kurse, për parcelën e dytë është lëshuar leja ndërtimore.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se në mbledhjen e kaluar të kuvendit ka kërkuar informacione për këtë objekt dhe nuk më është sjell asgjë. Ka thashetheme shumë për objektin në fjalë për mënyrën se si po ndërtohet, kurse komuna po hesht.

Agron Perçuku, anëtar i KPF-së – ajo që më shtyri ta marrë fjalën janë diskutimet e drejtorëve, që paraqitën mendime të ndryshme për këtë objekt. As për renovim nuk ka të drejtë të fillojnë punimet pa ia lëshuar lejen, kurse punimet janë duke vazhduar. Mbrapa kësaj qëndron një njeri i fortë dhe se inspektorati nuk shkon për ta mbikëqyr objektin.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -- deklaroi se nuk është i njoftuar me këtë rast. Por, ai tha se sot do të merret me rastin e këtij objekti.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

9. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

10. Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

11. Kërkesë për përkrahje financiare

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

12. Propozim - vendim për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit”.

Izet Miftari, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – lidhur me këtë propozim, ai deklaroi se për mendimin tim ky titull duhet të jetë “Nderi i Qytetit”, sepse Latif Berisha ka lindur në Smrekonicë dhe është rritur e shkolluar në Komunën e Vushtrrisë, pavarësisht se ku ka jetuar.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se nuk po e kontestojmë kontributin e as vlerat e tij. Por, nëse vendosim bashkërisht ta ndajmë titullin “Nderi i Qytetit”, sipas rregullores nuk kemi të drejtë t’i ndajmë dikujt tjetër këtë vit.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – në këtë pjesë po pajtohem me drejtorin, me u bazuar në rregullore, titulli “Qytetar Nderi” u jepet banorëve të komunave tjera. Ne si Vushtrri, po e bëjmë të komunës tjetër, duke e nderuar ne po e largojmë nga komuna jonë. Edhe unë pajtohem që të jetë titulli “Nderi i Qytetit”. Por, qysh do që ta mendoni ne pajtohem, sepse e rëndësishme është që të nderohet figura.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

13. Pyetje dhe përgjigje.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së –pyeti se a ka vullnet të kryhen pagesat për fëmijët e porsalindur. A janë duke u proceduar këto pagesa? Deri ku ka shkuar procesi i shujtave të mësimdhënësve?

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – sa u përket pagesave për fëmijët e porsalindur, arsyeja e vonesës ka qenë që nuk kemi pasur mjete financiare. Kurse, tashmë janë bërë pagesat. Sa u përket shujtave të mësimdhënësve, është bërë procedimi sipas marrëveshjes që e kemi pasur ndërmjet gjykatave. Tash e kemi edhe këstin e fundit në muajin mars dhe e përmbyllim këtë proces.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – lidhur me vaksinimin, ajo tha se në shkolla po i njoftojnë që do të shkojnë për t'i vaksinuar nxënësit, por ekipet e vaksinimit nuk kanë shkuar. Më vonë e kam kuptuar që disa prindër kanë heziturar t'i vaksinojnë fëmijët dhe për këtë arsye është ndaluar. A ka dikush informacion për këtë çështje?


Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – deklaroi se në seancën e kuvendit do ta sjell drejtorin e shëndetësisë dhe drejtoreshën e QKMF-së dhe të gjitha pyetjet ua adresoni atyre, pasi që e kemi edhe informatën për shëndetësi.

Mentor Hasani, anëtar i KPF-së – është e vërtetë që një numër i prindërve kanë heziturar t'ua japin fëmijëve këtë vaksinë, sepse është një vaksinë e re. Sa i përket orarit të vaksinimit, ai ka filluar sipas orarit dhe me kohë. Informimi bëhet 3-4 ditë përpara, ku njoftohet drejtori i shkollës. Ju kanë dhënë përparësi vendeve rurale.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – kalendari obligativ i vaksinimit propozohet nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe miratohet nga Ministria e Shëndetësisë, i cili bazohet në Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe i obligon qytetarët që nga lindja e deri në moshën 18 vjeçare që të vaksinohen. Vaksinimi është forma më e lirë dhe më efikase për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe vdekjeve të parakohshme. Procesit të vaksinimit është me rëndësi që t'i paraprihet me procesin e edukimit shëndetësor të prindërve dhe komunitetit se pse është e rëndësishme që t'i vaksinohen fëmijët.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës



Melihate Basholli - Latifi

Kryesuese e KK-së dhe KPF- së